

Terma Reference

Trajner për Workshop-e me Gra dhe Vajza mbi Dhunën me Bazë Gjinore (GBV), të Drejtat e Grave dhe Rolin e Shërbimeve Shëndetësore

Konsulencë	Trajner për Workshop-e me Gra dhe Vajza mbi Dhunën me Bazë Gjinore (GBV), të Drejtat e Grave dhe Rolin e Shërbimeve Shëndetësore Tirana për Gratë: Barazi, Mbrojtje dhe Fuqizim
Kohezgjatja e shërbimit	3 muaj
Zona e projektit	Vaqar, Ndroq dhe Pezë
Data e mundshme e fillimit të shërbimit	10 Tetor 2025 – 10 Janar 2026

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, në kuadër të projektit “Tirana për Gratë: Barazi, Mbrojtje dhe Fuqizim”, të mbështetur nga Bashkimi Evropian përmes Skemës së Granteve të Vogla të administruar nga GADC, po kërkon të angazhojë një trajner/ekspert me përvojë në çështjet e të drejtave të grave, shëndetin publik dhe adresimin e dhunës me bazë gjinore (GBV).

Ky rol është i rëndësishëm për fuqizimin e grave dhe vajzave nga zonat rurale të Vaqarrit, Ndroqit dhe Pezës, duke i informuar, ndërgjegjësuar dhe pajisur me njohuri praktike për mekanizmat e mbrojtjes dhe rrugët institucionale të aksesueshme për mbështetje.

Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Mision i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjitet të tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Përshkrimi i Projektit

Nisma ARSIS po zbaton projektin “Tirana për Gratë: Barazi, Mbrojtje dhe Fuqizim”, i cili synon të përmirësojë përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore (GBV) përmes forcimit të rolit të institucioneve shëndetësore dhe përfshirjes aktive të komuniteteve të marginalizuara në monitorim dhe ndërgjegjësim.

Një nga sfidat kryesore që adreson projekti lidhet me aksesin e pabarabartë të grave dhe vajzave veçanërisht atyre nga komunitetet e marginalizuara në shërbime të sigurt, dinjitoze dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në sistemin e kujdesit shëndetësor. Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë shpesh pika e parë e kontaktit për viktimat e dhunës me bazë gjinore, por kapacitetet e tyre për identifikimin e hershëm, mbështetjen me qasje të ndjeshme ndaj traumës dhe përdorimin e mekanizmave të referimit mbeten të kufizuara, veçanërisht në zonat rurale si Vaqar, Ndroq dhe Pezë.

Objektivat e Angazhimit

Të konceptojë dhe zhvillojë 3 workshop-e ndërgjegjësuese me gjithsej 50 gra dhe vajza nga zonat rurale, me qëllim forcimin e njohurive dhe aftësive të tyre në lidhje me:

- Dhunën me bazë gjinore (GBV) dhe format e saj.
- Të drejtat e grave dhe vajzave në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Rolin e shërbimeve shëndetësore dhe institucioneve të tjera për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave.
- Mekanizmat ekzistues të referimit dhe mbështetjes në nivel lokal.

Roli dhe përgjegjësitë

Trajneri i përzgjedhur do të:

- Hartojë metodologjinë dhe agjendën e workshop-eve të përshtatura për nivelin e kuptueshmërisë së grave dhe vajzave lokale, shumë prej të cilave mund të kenë njohuri të kufizuara mbi këto tema.
- Zhvillojë gjashtë workshop-e ndërvepruese, duke përdorur metoda praktike si diskutime të hapura, ushtrime pjesëmarrëse dhe raste konkrete.
- Pajisë pjesëmarrëset me informacion të qartë, të aksesueshëm dhe të dobishëm mbi shërbimet e disponueshme dhe mënyrat e qasjes në mbështetje institucionale.
- Sigurojë një atmosferë të sigurt dhe mbështetëse gjatë workshop-eve, e ndjeshme ndaj situatave të mundshme të traumës.
- Përgatisë një raport përfundimtar mbi realizimin e workshop-eve, pjesëmarrjen dhe reagimet e grave dhe vajzave.

Produktet e pritshme

- Agjenda dhe materialet e trajnimit (miratohen nga Nisma ARSIS përpara fillimit të workshop-eve) (një ditë e gjysëm).
- Zhvillimi i tre workshop-eve (një ditë secili, 50 pjesëmarrës në total).
- Raport përfundimtar (5–7 faqe) me përmbledhje të përmbajtjes së trajtuar, pjesëmarrjen, vlerësimin e trajnimit dhe rekomandime për ndërtim të mëtejshme kapacitetesh (një ditë e gjysëm).

Kualifikimet dhe Eksperienca e Kërkuar

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

Arsimi dhe Kualifikimet Akademike:

- Diplomë Master ose më e lartë në Shkenca Sociale (Punë Sociale, Psikologji, Pedagogji ose fusha të ngjashme).
- Ekspertizë e dëshmuar në fushën e GBV, qasje të ndjeshme ndaj traumës dhe trajnime shumëdisiplinore.
- Eksperiencë e mëparshme në trajnime me profesionistë të kujdesit shëndetësor në Shqipëri ose rajon.

Eksperienca Profesionale:

- Të paktën 5-7 vjet përvojë në hartimin e kurrikulave trajnuese për profesionistët ofrues të shërbimeve sociale.
- Pjesëmarrje në projekte të mëparshme që lidhen me ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve të shërbimeve sociale.

Afatet dhe dorëzimet që priten nga eksperti

Eksperti pritët të dorëzojë:

- Materialet e trajnimit (prezantime, udhëzues, pyetësorë vlerësimi, etj.)

Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 10 tetor 2025.

Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës 10 Tetor 2025 – 10 Janar 2026.

Kjo ekspertizë përfshin 6 ditë pune.

Procedura e aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email:

1. CV-në;
2. Letër interesi që shpjegon dhe përvojën në eksperiencë të ngjashme;

brenda datës **30 shtator 2025** në info@nisma-arsis.org, në përgjigje të ftesës me email.